VENDIM
Nr. 118, datë 22.8.2012

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "ALBPETROL" SHA NË AKTIVITETIN E TRANSMETIMIT TË GAZIT NATYROR

Në mbështetje të ligjit nr. 9946, datë 30.6.2008 "Për sektorin e gazit natyror ", nenit 14 pika 1 germa "a", si dhe të "Rregullave dhe procedurave për licencimin, ndryshimin, transferimin e pjesshëm ose të plotë, heqjen dhe rinovimin e licencave në sektorin e gazit natyror", nenit 4 pika 1 germa "a", nenit 5, nenit 8, nenit 9 pika 1 germave "a", "b", "c", "d", pika 2 germa "a" dhe nenin 11 dhe 12 pika 1, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 9, datë 11.2.2011, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.8.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Albpetrol" sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Albpetrol" sh.a., për licencimin në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror të kësaj shoqërie plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE-ja në rregulloren "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave",

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "Albpetrol" sh.a., në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror, për një afat 30-vjeçar, sipas licencës bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Shoqëria "Albpetrol" sh.a. do të paguajë tarifën e aplikimit në momentin e miratimit të saj nga ERE-ja.
3. Shoqëria "Albpetrol" sh.a. detyrohet të zbatojë të gjitha detyrimet që burojnë nga ligji nr. 9946, datë 30.6.2008 "Për sektorin e gazit natyror" dhe kushteve të licencës bashkëlidhur këtij vendimi.
4. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani